

25/07/2023

KOLEJI UNIVERSITAR “LOGOS” PJESE E SHKOLLES VERORE NDERKOMBETARE, UNIVERSITETI IONIAN I KORFUZIT



Nga data 10 deri më 22 korrik 2023, Departamenti i Historisë i Universitetit Jonian të Korfuzit, Greqi zhvilloi shkollën verore ndërkombëtare me temë “Detarët në Greqinë e lashtë: piratët, marinarët, kolonët”, me përgjegjës shkencor Prof. Athanasios A. Efstathiou, Dekan i Fakultetit të Shkencave Humane. Përgjegjës akademik ishin Dr. Polikseni Strolonga dhe Dr. Konstantinos Stefou. Seminari u fokusua në forma të ndryshme detarësh në Greqinë e lashtë, nga piratët dhe marinarët e deri te kolonët. Në përgjithësi, u studiuua roli i marinarëve në udhëtimet

mitike, lëvizjet e popullsisë dhe betejat detare nga epoka arkaike deri në atë helenistike. Përveç leksioneve të përditshme nga studiues dhe profesorë, programi përfshinte vizita në vende dhe atraksione arkeologjike.

Në kuadër të bashkëpunimit të Kolegjit Universitar "LOGOS" me Universitetin Jonian të Korfuzit, në këtë shkollë verore mori pjesë Ass/Lektore Lina Basoukou, e cila ka përvojë të gjatë në studimin e Historisë dhe Civilizimit Grek (Departamenti i Gjuhëve dhe Historisë). Përvojën e saj arsimore. Tema e saj e referencës ishte "Greqia Antike dhe Moderniteti".



fuqi jete!









[Kolejii Universitar "LOGOS"](#)